**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1812/4 prot. Tiranë, më 29.07.2026

# V E N D I M

**Nr. 29, datë 29.07.2026**

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 10 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

## KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. , ka paraqitur ankesën e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") me nr. 1812 prot., datë 29.06.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" (në vijim "Autoriteti Publik").

Nëpërmjet kërkesës për informacion të datës 24.06.2026, drejtuar Autoritetit Publik, ankuesi ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni mbi:

- *Sasinë (peshën) dhe vendin e origjinës së importeve të matësve të energjisë elektrike (kodi tarifor 9028 30) dhe koncentratorëve të të dhënave (kodi tarifor 8517 62 ose ekuivalentët e Smart Grid);*
- *Vlerën totale statistikore (CIF/FOB) të deklaruar në doganë nga kjo kompani për këto importe specifike;*
- *Shumën totale të detyrimeve doganore dhe TVSH-së në import të llogaritur dhe të paguar nga kjo kompani për mallrat e importuara nën këto kode tarifore.*

Autoriteti Publik, në përgjigjen e kthyer nëpërmjet *e-mail*-it të datës 25.06.2026, ka refuzuar dhënien e informacionit, duke argumentuar se: *"Informacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion, pasi përmban të dhëna që lidhen me aktivitetin tregtar të një pale të tretë dhe, si të tilla, konsiderohen informacion konfidencial. Në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", e drejta për informim kufizohet kur dhënia e informacionit cenon sekretin tregtar ose interesat tregtarë e ekonomikë të personave të tretë, të mbrojtura nga legjislacioni në fuqi. Duke qenë se informacioni i kërkuar përmban të dhëna mbi aktivitetin tregtar të një subjekti të tretë,*

*zbulimi i tij do të cenonte interesat e ligjshëm tregtarë të këtij subjekti, ndaj Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë kufizimet e parashikuara nga ligji. Për sa më sipër, kërkesa e gazetarit nuk mund të pranohet".*

Ankuesi, nga ana tjetër, ka pretenduar se: *"(i) informacioni i kërkuar nuk përbën asnjë sekret tregtar. Të dhënat mbi sasinë e mallit të importuar, vlera e tyre totale statistikore dhe detyrimet doganore të paguara në buxhetin e shtetit janë të dhëna sasiore dhe financiare që lidhen me zbatimin e legjislacionit fiskal dhe doganor. Ato nuk zbulojnë asnjë sekret teknologjik, formulë, marrëdhënie ekskluzive apo element strategjik që do të cenonte konkurrencën e lirë në treg; (ii) kompania "ACI Engineering" ShPK është përfitues i dhjetëra miliona eurove nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, përmes kontratave publike të prokurimit me OSHEE për furnizimin dhe vendosjen e matësve inteligjentë. Në këtë kuadër, ekziston një interes publik i jashtëzakonshëm për të verifikuar nëse sasia, cilësia, origjina dhe mbi të gjitha vlera e deklaruar në doganë e këtyre mallrave përputhet me detyrimet kontraktuale, kontraktuar me paratë publike; Dogana ka dështuar të zbatojë pikën 2 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, e cila saktëson se kufizimi i së drejtës për informim nuk zbatohet kur tërësi publik për njohjen e informacionit është më i madh se dëmi që pretendohet se shkaktohet. DPD nuk ka kryer asnjë "test dëmi" dhe asnjë "test të interesit publik", por ka refuzuar automatikisht, duke dëmtuar punën tonë për transparencë dhe llogaridhënie".*

Për sa më sipër, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 1812/1 prot., datë 06.07.2026, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin e tij lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 10.07.2026.

Në vijim, në përgjigjen e kthyer nëpërmjet *e-mail*-it të datës 06.07.2026, Autoriteti Publik parashtroi se: *"Megjithëse kërkesa është formuluar si kërkesë për të dhëna statistikore, informacioni buron nga të dhëna mbi deklaratat doganore individuale të një operatori ekonomik dhe lidhet drejtpërdrejt me aktivitetin e tij tregtar. Kodi Doganor mbron informacionin konfidencial të çdo operatori ekonomik (neni 20[1]). Në praktikë kjo do të*

[1] Në këtë dispozitë përcaktohet se: *"1. Çdo informacion i marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, i cili është i një natyre konfidenciale ose që është marrë në mënyrë konfidenciale, mbulohet nga kushti i sekretit profesional. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 48, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ka dhënë atë. Megjithatë ky informacion mund*

*thotë se deklaratat doganore, vlerat e importeve, çmimet, kontratat, furnitorët, informacioni tregtar, nuk mund të shpërndahen lirisht, pasi konsiderohen informacion konfidencial. Nëse të dhënat jepen të përmbledhura sipas vitit ose muajit, pa identifikuar importues të veçantë, përgjithësisht nuk cenohet konfidencialiteti. Siç e kemi theksuar dhe më parë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave jep të dhëna statistikore të agrevuara (të përgjithshme sipas grupit/nëngrupit përcaktues të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave) dhe listës joshteruese të operatorëve që kanë vepruar me autoritetin doganor (për periudhën/mallin përkatës). Sipas ankesës së subjektit, ligji nr. 119/2014 kërkon që autoriteti: të provojë konkretisht dëmin që shkakton publikimi, si dhe të kryejë testin e dëmit dhe interesit publik. Të dhënat statistikore mbi importet publikohen rregullisht nga institucioni shtetëror INSTAT bazuar në ligjin për statistikat zyrtare në RSH. Administrata Doganore administron informacion të marrë nga operatorët ekonomikë në kuadër të procedurave doganore. Vëllimet e furnizimit (sasi/copë/njësi), burimet e furnizimit (origjina), vlerat ekonomike të importeve (CIF/FOB), struktura financiare e transaksioneve (vlera) përmbajnë elemente të rëndësishme të strategjisë tregtare të operatorëve ekonomikë. Publikimi i këtyre të dhënave mund të krijojë avantazh konkurrues për subjektet e tjera në treg (konkurrencë e padrejtë në treg). Për këtë arsye, dhënia e këtij informacioni (vetëm për një operator tregtar) do të cenonte konfidencialitetin e informacionit tregtar të administruar nga autoriteti doganor. Publikimi i të dhënave të kërkuara nuk është i domosdoshëm për garantimin e transparencës së veprimtarisë së administratës doganore (testi i interesit publik), pasi institucioni (përfshi edhe INSTAT, apo agjenci të tjera statistikore) publikon/jnë periodikisht statistika të përgjithshme mbi tregtinë e jashtme. Autoriteti ka zbatuar parimin e proporcionalitetit, pasi duke analizuar natyrën e informacionit, rrezikun e identifikimit të operatorëve dhe dëmin e mundshëm ekonomik ndaj subjekteve, ka çmuar se kufizimi i së drejtës për informim është masa më e përshtatshme dhe proporcionale. Si përfundim kërkesa nuk lidhet me të dhëna statistikore, por me informacion ekonomik të operatorit privat, pasi informacioni i kërkuar nuk ekziston si një dokument administrativ autonom, por kërkohet të krijohet nga përpunimi drejtpërdrejt nga deklaratat doganore individuale të 1 (një) operatori ekonomik për një periudhë të caktuar. Për aq sa publikimi i këtyre të dhënave (në formën e kërkuar) lejon identifikimin që mundëson statistikën të kthehet në informacion që individualizon operatorin dhe e cila mund t'u japë përparësi konkurrentëve mbi informacionin për politikën tregtare të këtij operatori, nga ana e autoritetit (Kodit Doganor) konsiderohet si informacion që përbën interes ekonomik të mbrojtur, si i tillë, administrata nuk është e detyruar të presë që dëmi ekonomik të ndodhë përpara se të refuzojë dhënien e informacionit, për kategoritë e parashikuara si nga Legjislacioni Doganor, ashtu edhe në Ligjin për të Drejtën e Informimit".*

Pas shqyrtimit të qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, si dhe në konsideratë të pretendimeve të ankuesit, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në

*të jepet pa leje, kur autoritetet doganore janë të detyruara ose të autorizuara ta bëjnë këtë në përputhje me dispozitat në fuqi, veçanërisht me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave ose kur ka lidhje me procedimet gjyqësore. 2. Informacioni konfidencial, i përmendur në pikën 1, mund t'u komunikohet autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente të vendeve apo territoreve jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për qëllime të bashkëpunimit doganor me ato vende apo territore, bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare ose në legjislacionin kombëtar në fushën e tregtisë. 3. Çdo dhënie ose komunikim i informacionit, të përmendur në pikat 1 dhe 2, duhet të sigurojë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, në përputhje të plotë me dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave".*

zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore. Gjatë seancës, e cila u zhvillua datën 14.07.2026, ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik i qëndruan pretendimeve të tyre, të parashtruara në aktet e sipërpërshkruara.

Në eventualitetin e këtyre fakteve, si dhe bazuar në kuadrin ligjor rregullator, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të palëve, krahas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vëren se çështja objekt shqyrtimi nuk limitohet në disponimin ose jo nga autoriteti publik i informacionit të kërkuar, por lidhet kryesisht me ligjshmërinë e kufizimit të aksesit në të, për rrjedhojë nevojitet një interpretim harmonik i përcaktimeve sipas LDI-së, Kodit Doganor dhe standardeve kushtetuese, si dhe jurisprudencës ndërkombëtare që rregullojnë të drejtën për informim.

Komisioneri çmon të sjellë në vëmendje se e drejta për informim gjen mbrojtje në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit çdo person ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion mbi veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione publike. Kjo dispozitë kushtetuese nuk garanton vetëm një të drejtë individuale për njohjen me dokumentet zyrtare, por përfaqëson një mekanizëm themelor të kontrollit ndaj veprimtarisë së autoriteteve publike. Në këtë optikë, transparenca e veprimtarisë së tyre administrative dhe llogaridhënia në kuadër të informimit publik përbëjnë elemente të pandashme të shtetit të së drejtës. Ato mundësojnë që publiku të verifikojë nëse autoritetet publike ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, efikase dhe në mbrojtje të interesit publik. Në këto kushte, thirren për zbatim dispozitat e LDI-së, si një ligj i konceptuar mbi parimin se aksesimi i informacionit publik është rregulli, ndërsa kufizimi përbën përjashtimin, i cili duhet të interpretohet ngushtësisht.

Referuar parashikimit në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së: *"Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Në kuptim të këtij parashikimi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI-ja, në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike"*.

Sikurse është përshkruar më sipër, Autoriteti Publik e ka refuzuar kërkesën për informacion bazuar në nenin 20 të Kodit Doganor, duke pretenduar se *informacioni i kërkuar (vetëm për një operator tregtar) përmban elemente të rëndësishme të strategjisë tregtare të operatorëve ekonomikë dhe se publikimi i këtyre të dhënave mund të krijojë avantazh konkurrues për subjektet e tjera në treg (konkurrencë e padrejtë në treg), për këtë arsye, dhënia e këtij informacioni (vetëm për një operator tregtar) do të cenonte konfidencialitetin e informacionit tregtar të administruar nga autoriteti doganor*.

Gjithashtu, konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtruar për mosdhënie të informacionit, ka referuar se ka zbatuar parimin e proporcionalitetit, pasi duke analizuar natyrën e informacionit, rrezikun e identifikimit të operatorëve dhe dëmin e mundshëm ekonomik ndaj subjekteve, ka çmuar se kufizimi i së drejtës për informim është masa më e përshtatshme dhe proporcionale.

Lidhur me referimin e Autoritetit Publik në nenin 20 të Kodit Doganor, Komisioneri vëren se kjo dispozitë nuk vendos një ndalim absolut të komunikimit të çdo informacioni të administruar nga autoritetet doganore. Dispozita e lidh sekretin profesional me informacionin, që është i një natyre konfidenciale ose që është marrë në mënyrë konfidenciale dhe, njëkohësisht, parashikon shprehimisht mundësinë e komunikimit të tij pa lejen e personit ose autoritetit që e ka dhënë, kur autoritetet doganore janë të detyruara ose të autorizuara ta bëjnë këtë në përputhje me dispozitat në fuqi.

Në këto kushte, parashikimet e nenit 20 të Kodit Doganor dhe të ligjit nr. 119/2014 duhet të interpretohen në mënyrë të harmonizuar. Neni 17, pika 3 e ligjit nr. 119/2014, parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet kur përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji, por e kushtëzon një kufizim të tillë me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e tij. Për rrjedhojë, referimi në nenin 20 të Kodit Doganor nuk mjafton, në vetvete, për të justifikuar refuzimin e aksesit, por kërkon vlerësimin nëse informacioni konkret gëzon mbrojtjen e sekretit profesional dhe nëse dhënia e tij do të cenonte këtë interes në mënyrë të tillë që ta bënte kufizimin e aksesit të domosdoshëm dhe proporcional.

Komisioneri vlerëson se fakti që të dhënat e kërkuara burojnë nga deklarata doganore individuale nuk përbën, në vetvete, argument të mjaftueshëm për refuzimin integral të kërkesës. Autoriteti Publik duhet të identifikojë konkretisht natyrën e mbrojtur të informacionit dhe të arsyetojë, për secilën kategori të kërkuar, mënyrën se si dhënia e tij do të cenonte interesin e mbrojtur, si dhe përse ky kufizim është i domosdoshëm dhe proporcional. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t'i vihet në dispozicion kërkuesit, në përputhje me nenin 17, pika 6 e ligjit nr. 119/2014.

Në analizë të pretendimit[2] të Autoriteti Publik se informacioni i kërkuar kufizohet për shkak se përmban të dhëna që përbëjnë sekret tregtar, sipas përcaktimit në nenin 17 të LDI-së, Komisioneri vëren se sipas nenit 2, pika 3/1 e ligjit nr. 119/2014, "sekreti tregtar" ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar. Për rrjedhojë, jo çdo informacion që lidhet me veprimtarinë

[2] *Në përgjigjen e parë të kthyer për ankuesin.*

ekonomike të një operatori përbën, për këtë shkak, sekret tregtar, por duhet të vlerësohet nëse informacioni konkret plotëson kushtet ligjore për t'u konsideruar i tillë. Po ashtu, në nenin 18 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, përcaktohet qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Ndërsa, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: *"2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik".*

Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka kërkuar formulat teknologjike të pajisjeve, marrëveshjet kontraktore me furnitorët, strukturën e kostove, marzhet e fitimit apo elemente të tjera të strategjisë tregtare të operatorit ekonomik, por ka kërkuar të dhëna statistikore dhe financiare mbi mallra të importuara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e kontratave publike dhe me administrimin e të ardhurave publike.

Në këto rrethana, mbrojtja e pretenduar e sekretit tregtar nuk mund të shtrihet automatikisht mbi çdo element të informacionit të kërkuar, por kërkon një analizë të diferencuar për secilën kategori të dhënash, analizë e cila mungon plotësisht në aktin e Autoritetit Publik.

Një nga elementet thelbësore të ligjit nr. 119/2014 është detyrimi i autoritetit publik për të kryer testin e interesit publik, i cili nuk përbën një formalitet procedural, por një analizë substanciale që duhet të paraprijë çdo vendim për kufizimin e së drejtës së informimit. Ky detyrim buron nga neni 17 i ligjit dhe është shprehje e parimit të proporcionalitetit, i cili kërkon që kufizimi i një të drejte themelore të jetë i domosdoshëm, i përshtatshëm dhe proporcional me qëllimin legjitim që synon të mbrojë.

Në këtë kuptim, ndonëse Autoriteti Publik ka pretenduar se ka analizuar natyrën e informacionit, rrezikun e identifikimit të operatorëve dhe dëmin e mundshëm ekonomik ndaj subjekteve, duke konkluduar se kufizimi i së drejtës për informim është masa më e përshtatshme dhe proporcionale, Komisioneri vëren se arsyetimi i Autoritetit Publik nuk përmban një analizë individuale të secilës kategori informacioni të kërkuar, por e ka refuzuar plotësisht kërkesën për informim. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit, pasi shmang analizën konkrete të çdo elementi të informacionit dhe nuk lejon identifikimin e pjesëve të informacionit që mund të bëhen publike, duke mbrojtur njëkohësisht elementet që eventualisht mund të përbëjnë sekret tregtar.

Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik ka bërë një interpretim tepër të zgjeruar të nocionit të sekretit tregtar, duke përfshirë në të çdo informacion që lidhet me deklaratat doganore, pa bërë dallimin ndërmjet elementeve që realisht gëzojnë mbrojtje dhe atyre që, për shkak të interesit publik, duhet të bëhen të aksesueshme. Në këtë rast, Autoriteti Publik nuk ka shpjeguar pse çdo kategori informacioni përbën sekret tregtar, cili është dëmi konkret që do të shkaktohej, pse ky dëm mbizotëron mbi interesin publik, pse nuk ishte e mundur dhënia e pjesshme e informacionit, duke anonimizuar vetëm elementet që eventualisht do të gëzonin mbrojtje.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se mungesa e testit të interesit publik në rastin objekt shqyrtimi përbën një mangësi thelbësore të procedurës administrative, e cila cenon

ligjshmërinë e aktit të refuzimit, pasi informacioni i kërkuar nuk lidhet ekskluzivisht me aktivitetin privat të një operatori ekonomik, por me verifikimin e origjinës, sasisë dhe vlerës së pajisjeve që, sipas pretendimeve të ankuesit, janë përdorur në zbatimin e kontratave publike për furnizimin dhe instalimin e matësve të energjisë elektrike dhe koncentratorëve të të dhënave, çka lidhet drejtpërdrejt me transparencën në përdorimin e fondeve publike për procedura prokurimi lidhur me zbatimin e kontratave me vlerë të konsiderueshme ekonomike, në funksion të forcimit të besimit të publikut në administrimin e fondeve publike në mënyrë të ligjshme dhe efektive.

Për këtë arsye, interesi publik paraqitet dukshëm më i lartë se interesi privat për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të kërkuar, veçanërisht kur autoriteti nuk ka provuar ekzistencën e një dëmi konkret që do të shkaktohej nga publikimi i tij.

Në praktikën kushtetuese dhe atë evropiane është pranuar se mbrojtja e interesave ekonomikë përbën një qëllim legjitim për kufizimin e së drejtës për informim, por kjo mbrojtje nuk ka karakter absolut. Përkundrazi, ajo duhet të interpretohet në mënyrë restriktive dhe vetëm për aq sa është e domosdoshme për të shmangur një dëm konkret dhe të provueshëm.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës gazetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe subjektet që kontribuojnë në debatin publik ushtrojnë funksionin e "mbikëqyrësit publik" (*public watchdog*). Po ashtu, praktika e konsoliduar e GJEDNJ-së kërkon që kufizimet e së drejtës së informimit të mbështeten në arsye "relevante dhe të mjaftueshme". Në mungesë të një arsyetimi të tillë, kufizimi në ushtrimin e së drejtës për informim nuk konsiderohet proporcional.

Në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*[3], Gjykata theksoi se ndalimi i aksesit në informacionin me interes publik mund të dekurajojë median dhe aktorët e tjerë publikë nga ushtrimi i rolit të tyre në kontrollin demokratik të institucioneve shtetërore.

Po në të njëjtën linjë, në çështjen *Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë*[4], theksoi ndër të tjera se aksesi në informacionin publik, në rrethana të caktuara, përbën pjesë integrale të lirisë së shprehjes të garantuar nga neni 10 i Konventës Evropiane, veçanërisht kur informacioni kërkohet për të ushtruar funksionin e kontrollit publik mbi veprimtarinë e autoriteteve shtetërore.

Ky standard u zhvillua më tej në çështjen *Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë*[5], në të cilin Gjykata vlerësoi se refuzimi i pajustifikuar për të dhënë informacion publik cenon jo vetëm interesin individual të kërkuesit, por edhe interesin e shoqërisë për të marrë informacion mbi mënyrën e funksionimit të institucioneve publike në kuadër të ushtrimit të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të Konventës.

---

[3] *Case of Társaság a Szabadságjogokért v. Hungary (application no. 37374/05) 14/07/2009:* https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-92171%22]}.

[4] *Case of magyar helsinki bizottság v. Hungary (application no. 18030/11) judgment strasbourg 8/11/2016:* https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-167828%22]}.

[5] *Youth Initiative for Human Rights v. Serbia (application no.* 48135/06 *) judgment* 25.6.2013: https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22002-7585%22]}

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i kërkesës për informacion rezulton se ankuesi nuk ka kërkuar dokumentacion teknik mbi funksionimin e pajisjeve, teknologjinë e prodhimit, marrëdhëniet kontraktore me furnitorët, formulat e çmimeve, marzhet e fitimit apo elemente të tjera që mund të përbëjnë sekret tregtar në kuptimin klasik të këtij nocioni, por objekti i kërkesës konsiston në sasinë e mallrave të importuara, vendin e origjinës, vlerën statistikore të deklaruar në doganë, shumën e detyrimeve doganore dhe TVSH-së së importit. Këto të dhëna lidhen me ushtrimin e funksioneve publike nga administrata doganore dhe me administrimin e të ardhurave publike. Ato nuk identifikojnë domosdoshmërisht strategjinë tregtare të operatorit ekonomik dhe, mbi të gjitha, nuk është provuar se publikimi i tyre do të krijonte një avantazh real konkurrues për subjektet e tjera në treg. Po ashtu, informacioni kërkohet nga një gazetar për të kontribuar në debatin publik mbi administrimin e fondeve publike, si dhe informacioni lidhet me veprimtarinë e një autoriteti publik dhe me ushtrimin e funksioneve të tij ligjore dhe administrohet nga Autoriteti Publik, pavarësisht se për nxjerrjen e tij mund të nevojitet përpunimi i të dhënave ekzistuese.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të ligjit nr. 119/2014 dhe se, në rrethanat konkrete të çështjes, Autoriteti Publik nuk ka provuar ekzistencën e kushteve që do të justifikonin kufizimin e aksesit sipas nenit 17 të këtij ligji. Referimi i përgjithshëm në sekretin profesional doganor dhe sekretin tregtar, pa identifikuar për secilën kategori informacioni interesin konkret të cenuar, dëmin që do të shkaktonte publikimi dhe domosdoshmërinë e proporcionalitetin e refuzimit, nuk përbën bazë të mjaftueshme për kufizimin e së drejtës për informim.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI-ja ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër joshtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

**PËR KËTO ARSYE,**

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

**V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr. 1812 prot., datë 29.06.2026, të z. , kundër Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 24.06.206, konkretisht: *Sasinë (peshën) dhe vendin e origjinës së importeve të matësve të energjisë elektrike (kodi tarifor 9028 30) dhe koncentratorëve të të dhënave (kodi tarifor 8517 62 ose ekuivalentët e Smart Grid); Vlerën totale statistikore (CIF/FOB) të deklaruar në doganë nga kjo kompani për këto importe specifike; Shumën totale të detyrimeve doganore dhe TVSH-së në import të llogaritur dhe të paguar nga kjo kompani për mallrat e importuara nën këto kode tarifore),* brenda datës 07.08.2026.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 29.07.2026.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**